

## PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

### PËR AKTIVITETIN

ASGJËSIMI I VAJRAVE TË PËRDORUR PËRVEÇ INCINERIMIT (5.1 A)  
OSE LENDFILLIMIT (5.2.A).



### RIKIKLIMI I VAJRAVE TË PËRDORUR

SUBJEKTI: AMOS OIL SHA.

ADRESA: TIRANE VAQARR GODINE 1-KATESHE, ZONA KADASTRALE  
3321, NR PËSURIE 342/17.

## Qëllimit i projektit të propozuar;

**Shoqëria Amos Oil Sh.a** me Nipt K87508801F me vendodhje ne Tiranë Vaqarr Godinë 1-katëshe, zona kadastrale 3321, nr pasurie 342/17 dhe me objekt veprimtarie: Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim dhe modifikim strukturor të vajrave lubrifikantë të përdorur, i distilateve të pirolizave dhe mbetjeve të hidrokarbureve me destinacion prodhimin e bitumit dhe derivateve te tij ( vaj, graso etj).

Qëllimi i aktivitetit është riciklimi I vajrave te perdorur.

Me kërkesë të shoqërisë Amos Oil Sh.a po përpilohet studimi i gjendjes së zonës në të cilën do të kryhet aktiviteti i riciklimit te vajrave te perdorur me vendodhje Tirane Vaqarr Godine 1-kateshe, zona kadastrale 3321, nr pasurie 342/17.

## Kordinatat Gaus-Kruger.

Nr	X	Y
1	4395958.78	4573827.2
2	4396000.47	4573811.32
3	4395970.92	4573738.29
4	4395931.72	4573751.48

## Ortofoto e vendodhjes.



Foto te inplantit.







**Pjesë të furrës dhe vaskës së grumbullimit të mbetjeve të ngurta.**



Cfarë janë “vajrat e përdorura”

Vajrat e përdorura janë të gjitha vajrat minerale, lubrifikantë sintetikë apo industrialë që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin, për të cilin ishin prodhuar fillimisht. Vajrat e përdorura përfshijnë vajra të motorëve me djegie të brendëshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.

“Rigjenerim i vajrave të përdorura” është çdo operacion riciklimi, me anë të të cilit vajrat bazë mund të prodhohen nga rafinimi i vajrave të përdorura, në mënyrë të veçantë duke hequr ndotësit, produktet oksiduese dhe shtuesit e tjerë, që gjenden në këto vajra.

Vajrat e mbetura Direktiva mbi vajrat e mbetura 75/439/KEE, ndryshuar herën e fundit nga amendamenti i Direktives mbi vajrat e mbetura 2000/76/KE është projektuar për të krijuar një sistem në harmoni për mbledhjen, ruajtjen, rikuperimin dhe asgjësimin /depozitimin e mbetjeve vajore, siç janë vajrat lubrifikante për automjete, turbina, motore dhe vajrat hidraulike. Direktiva ka gjithashtu si qëllim mbrojtjen e mjedisit kundër efekteve të dëmshme që vijnë si pasojë e hedhjeve ilegale dhe të përpunimeve. Është e rëndësishme të grumbullohet sa më shumë në mënyrë që mos të ketë ndotje të mjedisit dhe të përfitohet sa më shumë nga kjo rrymë mbetjesh.

Shkalla e mbledhjes në BE është rreth 81%, por mund të përmirësohet edhe më tej. Për këtë industrinë, konsumatorët dhe ofcinat duhet të marrin pjesë jo duke i hedhur këto lëngje por duke i dorëzuar ato tek autoritetet e caktuara që do të ndërmarrin rigjenerimin e tyre. Vajrat e mbetura, duhet të mbledhen vecmas aty ku është e mundur teknikisht dhe gjithashtu të trajtohen. Mbetjet vajore nuk duhet të përzihen me mbetjet të tjera vajore ose me mbetjet të llojeve të tjera.

**Vajrat përfshijnë** vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale apo sintetike.

Vajrat e përdorura (VP) përfshijnë: a) vajrat e përdorura në motorët me djegie të brëndshme; b) vajrat e përdorura të kutive të shpejtësive (grasot); c) vajrat e përdorura lubrifikante minerale;

ç) vajrat e përdorura të turbinave; d) vajrat e përdorura hidraulike;

dh) mbetjet vajore nga depozitat;

e) përzierjet vaj - ujë;

ë) emulsionet.

Vajrat e përdorura janë mbetje të rrezikshme dhe trajtohen sipas kërkesave të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", e në mënyrë të veçantë të nenit 27 të këtij ligji.

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohen këto veprime:



Adresa: Lagja 7 Rr. Hajdar Demiri Durrës  
Cel +355 69 37 67 595  
E-mail: green-studio@hotmail.com  
 Green-Studio

- a) derdhja e vajrave të përdorura në ujërat sipërfaqësore, në ujërat nëntokësore, në ujërat territoriale detare, në sistemet e drenazhimit e të kullimit, si dhe në rrjetin e kanalizimeve të ujërave;
- b) depozitimi dhe/ose derdhja e VP-ve të dëmshme në tokë, si dhe çdo shkarkim i pakontrolluar i mbetjeve që rezultojnë nga përpunimi i tyre;
- c) përpunimi i VP-ve që shoqërohet me ndotje të ajrit mbi nivelet e lejuara të shkarkimeve në ajër, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) derdhja, hedhja, braktisja, groposja, përzierja me mbetje të tjera të ngurta i VP-ve;
- d) transportimi i VP-ve pa mjetet e nevojshme e pa qenë i pajisur me leje mjedisore dhe licencë të nënkategorisë III.2.B.
- dh) përgatitja për rigjenerim, rikuperim dhe asgjësim pa qenë i pajisur me licencë të nënkategorisë III.2.B, për të kryer këto veprimtari.

### **Përshkrimi i procesit teknologjik të impiantit.**

Figurat e mësipërme paraqesin një stabiliment i cili merret me riciklimin e hidrokarbureve dhe merr përsipër distilimin katalitik si dhe pastrimin e modifikimin kimik të distilateve të fituara nga distilimi i naftës si dhe i atyre të mara nga procesi i pirolizës së gomës dhe i plastikës.

Teknologjia e ofruar është një hap përpara në procesin e pastrimit të mbetjeve të riciklueshme pa shkatuar ndotjen e mjedisit.

Impianti është i përbërë nga këto linja :

1. Linja e distilimit të Distilivateve e kombinuar me prodhimin e bitumit.
2. Linja e distilimit katalitik dhe modifikimit strukturor të distilateve të mara nga procesi i distilimit si dhe ai i pirolizës.
3. Linja e regjenerimit të vajrave të përdorur e kombinuar kjo me prodhimin e grasos.

Linja 1 dhe 2 janë dy reaktore të ndryshëm që janë të lidhur me njëri-tjetrin me një sistem furrash termike dhe ngrohja e tyre bëhet nëpërmjet bludiesel-it si dhe gazit të riciklueshëm që del nga përpunimi i këtyre lëndëve. Sistemi është komplet një sistem i mbyllur dhe me rivers (rikthim). Është një teknologji e fundit me patente amerikane dhe me projektim kinez. Është miqësor ndaj mjedisit, nuk ka derdhje të dyta apo mbetje teknologjike pasi vetë impianti është projektuar për riciklimin e të gjitha mbetjeve urbane me origjinë hidrokarburesh dhe bimore.

Linja 3 është një linjë e përbërë me dy blendera, të cilat ngrohen me vaj termik të një temperature të caktuar. Blenderat janë të pajisur me një sistem aspirimi në të cilin avujt kalojnë nëpërmjet një depozitë me lëndë alkaike për pastrimin e cdo lloj avulli lubrifikant.

Të tre linjat janë të lidhura me njëra-tjetrën me tuba dhe pompa që funksionojnë ndërmjet njëra-tjetrës në një sistem totalisht të mbyllur. Transporti i lëndës parë dhe produktit do të realizohet nëpërmjet automjeteve cisternë të mbyllura hermetikisht dhe të sigurta nga ana teknike.



Linja është e përberë nga këto nyje kryesore:

Rezervuarët e lëndës së parë, distilate me kapacitet 200 m<sup>3</sup>, që do mbushen me anë të autoboteve të cilat plotësojnë të gjitha rregullat teknike të legjislacionit në fuqi.

Para-trajtimi i distilatit, është i përbërë nga : rezervuare me kapacitet 100 m<sup>3</sup> (dy copë) të destinuar për të pritur distilatet që do parapërgatitet për distilim. Rezervuarët janë të paisur me serpentina që realizojnë ngrohjen e lëndës për të bërë një largim të ujit, i cili nëpërmjet një tubi akumulohet në një depozitë tjetër të paracaktuar, dhe ky emulsion uji përdoret si lëndë dytësore për prodhimin e prajmerit.

Reaktori i distilimit të lëngut - do shërbejë reaktori i distilimit i cili është i paisur dhe me një kollonë rektifikimi për fraksionimin e distilateve të ndryshme.

Ftohës-kondesatori është i përbërë nga 4 serpentina të zhytura në një banjë uji dhe shërben për të kondësuar dhe ftohur avujt e produktit që rezultojnë nga procesi i distilimit dhe konkretisht : Fraksioni deri në 270° C pas ftohje-kondesimit kalon në ndarësin e ujit dhe pas procesit të stabilizimit drejtohet në rezervuarin respektiv me emërtimin tretës për tu trajtuar më pas konform destinacionit komponent për prodhim prajmeri. Gazi i pranishëm nga sipër separatorit, kalon në një enë e cila është e mbushur me një solucion alkalik ku bëhet pastrimi i tij nga prania e gazit H<sub>2</sub>S . Fraksioni 260°C deri në 340°C ,pas ftohje-kondesimit kalon në rezervuarin respektiv me destinacion , lëndë e parë për prodhimin e prajmerave të ndryshëm. Fraksioni 335°C deri në 380°C ,pas ftohje-kondesimit kalon në rezervuarin respektiv me destinacion , komponent për bitum, graso etj.

Grumbulluesi i produktit të rëndë , përbëhet nga një rezervuar i montuar poshtë reaktorit të distilimit (rezervuare nënëtokesor) i destinuar për të pritur produktin që mbetet në pjesën fundore të reaktorit , bitum rreshinor, shërben si komponent bazë për formulimin e bitumeve të forta.

Ftohësi i bitumit rreshinor është i përbërë nga një tufë serpentinash të zhytura në një banjë uji e cila shërben për të ftohur këtë produkt në një temperaturë poshtë temperaturës së vetëndezjes para se ai të pompohet në rezervuarin respektiv.

Manipulimi i Serës së Selenices , konsiston : në pritjen, seleksionin, copëtimin paraprak i cili realizohet për në destinacionet e caktuara, proces i cili do të realizohet në mënyrë mekanike në bluarjen dhe transportimin - ky proces do të realizohet me anë të një mulliri special bluarjeje ndërsa transportimi i serës së bluar për në blenderin e bitumit do realizohet me anë të një shneku.

Parku i rezervuareve të produkteve të gatëshme - përbëhet nga 7 rezervuare cilindrike horizontale, secili me volum 50 m<sup>3</sup> :

- dy rezervuare për depozitimin e biturnit, janë të paisur me serpentinë ngrohëse ku si agjent termik përdoret vaji i nxehtë.
- dy rezervuare për depozitimin e mazutit, janë të paisur me serpentin.
- një rezervuar për depozitimin e prajmit, është i paisur me serpentin.
- një rezervuar për depozitimin e lëndëve shpërbërëse (solven, ekzen etj.)





një rezervuar për depozitimin e diezelit për përdorim të brendshëm

Përshkrimi teknologjik

Linja e distilimit të distilateve dhe prodhimi i bitumit.

1. Distilimi i Lubrifikanteve

Distilatii i depozituar në depozitën D-301 ku është ngrohur në një temperaturë 30-35 °C dhe është shkalluar një pjesë e ujit, pompohet në depoziten D-302 deri sa niveli i lëngut të arrijë = 80%. Vihet në punë sistemi i mbartësit termik i depozitës për të rritur temperaturë e lëngut në 40-45°C, bëhet një shkarkim uji dhe me anë të pompës P-301 kalohet në paisjen dekantuese DK-301 deri sa niveli të arrijë=70% Vihet në punë sistemi ngrohës i dekantorit për të kapur një temperaturë të lëngut = 60°C, shtohet kimikat (de-emulgator), dhe lihet për të berë dekantimin e ujit dhe emulsionit; mbasi përfundon ky proces, distilati nga DK-301 po me në të pompës P-301 kalohet në depoziten e lëndës së parë D-303. Vazhdohet kjo procedure deri sa depozita D-303 të mbushet në rreth 70% të kapacitetit. Distilati i trajtuar e depozituar në rezervuarin D-303 , me anë të pompës P-302 kalohet në distilatorin RD-201 deri sa niveli i lëngut në të, të arrijë rreth 50%.

a. bëhet gati skema e mbushjes së paisjes me lubrifikant

b. matet sasia e lubrifikantit që ndodhet në rezervuarin D-302 dhe shënohet.

c. takohet pompa B-302, stabilizohet sasia e lëngut që dërgon pompa në RD-201 duke fiksuar një vlerë të amperazhit të pompës P-302 (amperazhi do shikohet tek AI-301); vlera e amperazhit fiksohet duke manovruar me bajpasin e pompës P-302.

d. Kontrollohet niveli i lëngut në RD-101 duke e parë dhe njëkohësisht duke bërë matje nëpërmjet bakaportes mbi reaktorin e distilimit RD-201. Kur niveli në RD-101 arrin rreth 50%, ndalet pompa P-302, bëhet matja e sasisë së lëngut në rezervuarin D-303 dhe me diferencë përcaktohet sasia e lëngut që u kalua në reaktorin e distilimit RD-101.

Mbushen me ujë ftohesat FC-101,201 , si dhe seperatorët e gazit SG-101/201, bëhet gati skema e kondesimit të produkteve të majave të kollonave të distilimit; takohet njeri nga sprucatorët e reaktorit RD-201. Rritet gradualisht temperatura në reaktorin e distilimit , fillimisht me 15-20°C 1 orë dhe me pas me 25-30°C/orë. Në vatësi të temperaturës që realizohet në pjesën e sipërme të kollonave të distilimit , avujt pasi kondesohen kalohen :

Mbasi temperatura në reaktorët e distilimit ka arritur vlerën 380°C, stakohen sprucatorët, sigurohemi që procesi i distilimit ka përfunduar dhe fillojmë të kalojmë gradualisht produktin që ndodhet në reaktorin e distilimit (bitum rreshinor) në rezervuaret RB-101. Takojmë pompat e mazutit PM-101/ PM-201 dhe pompojme mazutin për në rezervuarin RM-301 duke e ftohur paraprakisht në ftohësin FC-301. Vazhdohet kështu deri sa të pompohet i gjithë mazuti nga reaktorët e distilimit për në R-301, mbyllen valvulat pneumatike V-4, V-5 dhe përgatitemi për furnizimin me lëndë të parë për ciklin tjetër të distilimit.

Prodhimi i bitumit


Lëndë e parë për prodhimin e bitumit përdoret :

a) Bitum rrëshinor i prodhuar nga distilimi i distilateve

b) Serë selenice e pastruar seleksionuar dhe e bluar



Adresa: Lagja 7 Rr. Hajdar Demiri Durrës  
Cel +355 69 37 67 595  
E-mail: green-studio@hotmail.com



c) Mazut imare nga rafineritë

d) Aditivë për përmirësimin e vetive të bitumit

Bitumi rrëshinor ,i depozituar në rezervuarin R-301 me temperaturë konform kartës teknologjike , meret me anë të pompës P-303 dhe pompohet në depoziten e përcaktuar. Gjatë kësaj kohe, është e rëndësishme që të parandalohet derdhja nga sipër për efekt të shkumëzimit që mund të ndodhë si rezultat i pranisë së ujit në serën e bluar.

Në varësi të sasisë së mazutit që ndodhet ne BL-301, kalkulohet sasia e serës dhe fillohet të hidhet ajo me anë të shnekut gradualisht ; takohet përzjerësi i blenderit dhe periodikisht takohet pompa e qarkullimit P-303. Vazhdohet kështu deri sa të hidhet e gjithë sasia e serës dhe më pas gjithë produkti (bitumi) nga blenderi BL-301 kalohet në blenderin BL-302 ku do të bëhet përgatitja përfundimtare (homogjenizimi) i bitumit. Bitumi mbasi arrin karakteristikat e duhura, pompohet në depozitat respektive D-304, D-305 në parkun e produkteve të gatshme. Në parkun e produkteve të gatshme është parashikuar dhe vënd depozitimi dhe për mazutin ,respektivisht depozitat D-306, D-307, mazut i cili mund të tregetohet ose ruhet gjëndje për tu trajtuar më vonë.

Distilimi katalitik dhe modifikimi strukturor i distilateve

Procesi i distilimit realizohet në një reaktor cilindrik horizontal i cili është i montuar në një furrë ngohëse gjë e cila realizon temperaturën e nevojshme për procesin e distilimit. Teknologjia e pastrimit të distilateve bazohet në trajtimin kimik të tyre, trajtim i cili bëhet para procesit të distilimit , proces që largon një pjesë të komponimeve të dëmshme si merkaptane , rreshira , asfaltin e tjerë. Mbas pastrimit kimik, distilati distilohet në reaktorin e distilimit ku shtohet dhe katalizatori cili mundëson rritjen e shkallës së pastërtisë së distilatit; në varësi të produktit që duam të fitojmë. Skema teknologjike lejon modifikimin strukturor gjë që realizon reduktimin e përmbajtjes së squfurit,përmirësimin e ngjyrës dhe aromës. Proces tjetër i parashikuar në skemë është dhe filtrimi i produkteve për të garantuar një cilësi konform standarteve.

Konform skemës teknologjike, linja është e përbërë nga këto nyje kryesore:

Rezervuaret e lendës së parë, distilatit, i cili pompohet këtu nga rezervuaret e stabilizimit për tu trajtuar me tej.

Rezervuaret e trajtimit kimik, janë dy rezervuare të paisur me tronketa për injektimin e acidit dhe të bazës neutralizuese , nivel-tregues,armatura ,pompë për thithje - përzjerje si dhe dergimin e distilatit në reaktor.

Reaktori i distilimit katalitik është një prej paisjeve me kryesorë të impiantit dhe është i paisur me një dispozitiv pneumatik ngarkimi i vendosur në pjesën e sipërme, i cili mundëson furnizimin e paisjes me katalizator,kimikat gjatë procesit të distilimit.

Reaktori është i paisur me nje kollone distilimi e cila shërben për të marë produktet që rezultojnë nga procesi i distilimit. Edhe procesi i shkarkimit të produktit nga fundi i reaktorit të distilimit realizohet me anë të një dispozitivi pneumatik ; të dy këta dispozitive pneumatikë mundësojnë vazhdimin e procesit teknologjik pa qënë të detyruar të bëhet ftohja e reaktorit deri në temperaturën e ambient.



Ftohës-kondesatori është i përbërë nga 4 serpentina të zhytura në një banjë uji dhe shërben për të kondensuar dhe ftohur avujt e produktit që rezultojnë nga procesi i distilimit. Produkti pas ftohje-kondesimit kalon në rezervuarët e stabilizimit.

Grumbulluesi i produktit të rëndë , përbëhet nga dy rezervuare të montuar poshtë reaktorit të distilimit (rezervuare nëntokësor) të destinuar për të pritur produktin që mbetet në pjesën fundore të reaktorit pasi ka mbaruar procesi i distilimit. Produkti shkarkohet nëpërmjet dispozitave pneumatike.

Rezervuarët e stabilizimit të produktit të distiluar shërbejnë për të larguar ujin si dhe gazet e pranishëm. Gazi , para se të largohet nga rezervuari stabilizues, kalon në një enë e cila është e mbushur me një solucion alkaline ku bëhet pastrimi i tij nga prania e gazit H<sub>2</sub>S. Distilati i ndarë nga uji dhe mbeturinat eventuale pompohet me anë të pompës përkatëse në rezervuarin e distilatit.

Modifikuesi kimik (strukturor) është i përbërë nga dy paisje të paisuara me dispozitivet përkatës për hyrjen e distilatit e të kimikateve të zgjedhura me kujdes , përzjerjen e tyre, cka realizon heqjen e komponimeve squfuroze, dhe përmirësimin e aromes.

Filtrat , janë dy paisje të përbera nga rrjeta filtri me dimensione rigorozisht të përcaktuara që realizojnë filtrimin e distilateve. Janë të paisur me enë qelqi ku duket produkti pas filtrimit si dhe me ventila ku meret kampjon për analizë.

Rafinuesi katalitik-është i përbërë nga dy paisje vertikale të mbushura me katalizatorë special në të cilët bëhet rafinimi përfundimtar i distilateve ku realizohet qëndrueshmëria ndaj oksidimit dhe heqja totale e aromës së keqe.

Seperatorët e gazit , janë dy paisje vertikale,të mbushura me ujë (rreth 70%), ku gazi hyn me anë të një tubi i cili është i zhytur në ujë duke bërë në këtë mënyrë mbyllje hidraulike të të gjithë sistemit.

Rezervuarët e produkteve të gatshëm, përbëhen nga rezervuare cilindrike me kapacitet të mjaftueshëm për të pritur produktet përfundimtare.

Ky impiant është i teknologjisë bashkëkohore, makineritë dhe paisjet janë prodhuar sipas standarteve perëndimore dhe mundëson realizimin e një shkalle të thellë pastrimi të produkteve të dala nga procesi i distilimit të distilateve të fituara nga distilimi i lubrifikantëve si dhe të distilateve të mara nga procesi i pirolizës së plastikës apo gomës pa shkaktuar ndotjen e ambientit.

Montimi i paisjeve kryesore, lidhjet teknologjike janë kryer nga firma të licensuara duke vendosur tubacione armatura në përputhje me kushtet teknike të zbatimit (KTZ) gjë që siguron lëshim normal dhe mbarvajtje të punës gjatë procesit teknologjik.

Avantazhet e aktivitetit të përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve hidrokarbure, vajrave lubrifikante dhe distilanteve.

1.Avantazhet

- Riciklim i mbetjeve të rrezikshme nëpërmjet një teknologjie të avancuar dhe të pastër.

-Rritje e punësimit në nivel lokal



Adresa:Lagja 7 Rr Hajdar Demiri Durres  
Cel +355 69 37 67 595  
E-mail:green-studio@hotmail.com  
 Green-Studio

- Afërsia e tij me zonat kryesore të vendit, industriale, tregtare dhe të transportit.
- Kapaciteti i përpunimit të mbetjeve. mbetjeve.
- Ndodhet ne zone periferike nga qyteti.
- Menaxhimi i mbetjeve të impiantit në rrugë të tjera për prodhim bitumi dhe graso.
- Qarkullim i mbyllur i gazeve duke u vetëdjegur në furrën e impiantit, etj.

- Menaxhim i mbetjeve të rrezikshme me një teknologji të pastër dhe brënda kushtevetë miratuara me ligj.
- Plotësimi i detyrimeve ligjore nga subjekte të gjenerimit të vajrave si autoservise dhe industria mekanike.
- Ofrimi i produkteve cilësore, në treg me një cmim të konkurueshëm ne tregun vendas.
- Rritje e numrit të punësuarëve dhe rritja e kohëzgjatjes së punësimit.

### **Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:**

- a)Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në objekt për të reduktuar mundësitë e rënies se zjarrit në objekt dhe avaritë në sistem duke shmangur shperndarjen e produktit në mjedisin e zonës përreth. Djegia e lëndës së depozituar është tepër e dëmshme për mjedisin e zonës dhe banorët e zonës, të cilët kanë si një nga mënyrat kryesore të mbijetesës përdorimin e tokave bujqësore.
- b) Mbetjet hidrokarbure, ose vajrat lubrifikante të përdorur, të seperuara të grumbullohen dhe të rifuten për perpunim në impiant.
- c) Lidhur me mbetjet e grumbulluara për përpunim duhet që kompania të ketë një databasë të sasive që grumbullohen si dhe duhet të kontraktojë subjekte për grumbullimin dhe ruajtjen e tyre.
- d) Sasia depozituese të mos i kalojë volumet e parashikuara në mënyrë qe situata të jetë e kontrollueshme.
- e) Të zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri në mënyrë që të përballojë sasinë e depozituar të lëndës djegëse në raste të avarive të ndryshme.
- f) Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës. Punimet e mirëmbajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.

Trajtimi i mbeturinave të naftës dhe vajit në trajtë llumi realizohet ma anë të procesit të centrifugimit dhe me pas ajo kthehet në një burim të vlefshëm për tu ripërdorur. Vaji pasi është trajtuar mund të përdoret si vlerë e lartë kalorifike karburanti, në industrinë e cimentos, mund të përdoret si vaj bazë për prodhimin e lubrifikantëve. Kjo mënyrë jo vetëm kursen energjin, por shkurton dhe shpenzimet.

Nëse do të kemi një cilësi të lartë të vajit, automatikisht do të kemi edhe një karburant cilësor. Sasia e mbeturinave të naftës duhet të ruhet, e të transportohet me kujdes. Vaji i mbeturinave gjeneron shpenzime të mëdha, vecanërisht kjo ndihet në industrinë që punojnë me një numër të madh makinerish.





Vendet e zhvilluara përdorin teknologji, të cilat marrin përsipër disa procese, sic është edhe ndarja cetrifugaleja, që realizohet nëpërmjet damixhanëve ( decanter) dhe separatorëve me performance të lartë. Damixhanet përdoren në atë rast kur kemi një përmbajtje të lartë solide. Në fazën e dytë, separatori vetë-pastrues, mund të instalohet në drejtim të rrymes. Në këtë fazë bëhet ndarja e ujit nga materiali solid. Më pas vaji mund të përdoret për prodhimin e energjisë. Ndër fazat e përpunimit të vajrave të përdorur, më i rëndësishmi është procesi i centrifugimit, i cili bën ndarjen e vajit nga përberësit e tjerë.

Por gjatë këtij procesi, ka edhe funksione të tjera, të cilat lidhen me përparësitë e përdorimit të teknologjisë. Ndër to mund të përmendim

1. Të gjitha pjesët e makinerisë janë të ndërtuara nga material celiku inoks.
2. Krijimin e pellgjeve të cekëta
3. Konsumimi minimal i fuqisë.
4. Makineria është e ndërtuar me inteligjencë kinematike dhe me një shpejtësi të lartë diferenciale.
5. Efikasitet i lartë i lëvizjes së motorrit me shpejtësi të ndryshueshme
6. Rregullim automatik i shpejtësisë diferenciale
7. Është dizenuar në atë menyrë të sigurt në rastet e shpërthimit.

Makineria Clarifiers GEA është projektuar për pastrimin e karburantit, naftës, lubrifikimin e vajit hidraulik dhe trajtimin e mbeturinave të naftës. Makineria është dizenuar me sistem të mbyllur, i cili është pajisur me një gotë që tregon nivelin e naftës. Vepron me anë të tre fazave AC motor.



Makineria më sipër shërben për ndarjen dhe trajtimin e ftohjes së lubrifikantëve, largimin e naftës nga uji, lubrifikimin e vajit, largimin e mbeturinave nga nafta.

Përfitimet që mund të kemi:

1. Kosto operative e reduktuar që rezulton nga motorri, ndërrim më pak i shpeshtë i vajit.
2. Kapacitet i lartë i xhiros.
3. Efikasitet i lartë gjatë procesit të ndarjes së vajit nga përbërësit e tjerë.
4. Në saj të teknologjisë GEA hidrostop, bëhet kontrolli i shpejtë dhe njëkohësisht largim i trupave të ngurtë.
5. Ka përdorim të thjeshtë.
6. Shkakton nivel të ulët të zhurmës pasi makineria është e pajisur me rrip që ndihmon në uljen e zhurmës.

**Henan Dinter** është një makineri e vitit 2015 që shërben për trajtimin e vajërave të përdorur. Ajo bën trajtimin e vajrave, të gomave, vajrave plastikë, mbeturinave të vajrave të motorrit, vajrave të ndryshme nga tanket e naftës apo anijeve. Makineria bën transformimin, vecimin dhe lubrifikimin e vajit.

Model Number: DTLX

- Fuqia : 15 kw
- Certifikat : CE & ISO
- Trashësia e reaktorit : 16 mm
- Proces ftohje : Me anë të qarkullimit të ujit
- Materiali i reaktorit : Boiler Q 345R metal / 304 celik
- Model: DTLX-5,DTLX-10,DTLX-20,DTLX-30
- Voltazhe: 380 V
- Pesha: 30 ton

Më poshtë kemi një pajisje që quhet furrë ngrohjeje, e cila është shumë e rëndësishme në procesin e rafinimit. Këtu bëhet djegia e karburanitit me temperaturë të lartë.




Më poshtë kemi aparaturën e cila bën vecimin e vajit nga përberësit e tjerë dhe nga papastërtitë. Disa papastërti nuk treten në ujë dhe nën veprimin e katalizatorit, duke përdorur procesin e ngrohjes, bëjnë pastrimin e vajit.



Këto pajisje bëjnë të mundur largimin në mënyrë efektive të papastërtive që ndodhen në vaj, erërat e vecanta dhe në të njëjtën kohë mund të përmirësojnë dhe aftësinë ndezëse të naftës. Punohet nën presionin atmosferik, nuk ka aromë të vecantë, harxhon pak energji dhe mbron mjedisin. Pajisja ka kosto të ulët, konsumon pak vaj dhe ndihmon në ruajtjen e ngjyrës së vajit gjatë ruajtjes së tij.

Makinë filtrimi në mënyrë automatike.



Filtrat janë të ndërtua nga një rrjet i vecantë celiku, i cili është rezistentë, ka saktësi të lartë, mbetje të ulët të vajit, është i përshtatshëm për prodhimin e dekolimit të vajit, si edhe ndikon në kullimin, filtrimin dhe ndarjen e vajit.

Filtrimi i vajit me anë të tubave lubrifikues.

Aparatura më poshtë bën pastrimin e vajit, vecanërisht të vajit emulsiv, i cili për nga vetë karakteristikat, ka papastërti të lartë, përmbajtje të lartë të ujit dhe të gazit. Makinaria bën filtrimin e plotë. Në këtë mënyrë bëhet rigjenerimi i naftës duke e kthyer atë në ripërdorim.



Përparësitë e makinerisë:


1. Shkatërrimi i emulsifikimit arrihet me anë të një materiali të molekulës polimerike.
2. “Dewatering” është proces shumë efektiv i cili bën dehidratimin e plotë. Ai bën pastrimin e plotë të ujit deri në 100 %.
3. Filtrat janë të pajisur me rrjet trapezoidal FH dhe bëjnë përthithjen nga materiali polimer.
4. Është e pajisur me trapezoidale, në formë spirale, që funksionojnë me sistem automatik, me sistem shtytës.
5. Është e pajisur me dielektrike.
6. Pastrimi i naftës bëhet on line dhe realizohet me anë të turbinave me ujë në mënyrë automatike.

Avantazhet:

1. Pajisja ka aftësi të shkaterrojë plotësisht emulsifikimin dhe në këtë mënyrë nafta është shumë e vështirë të përzihet sërish pas trajtimit. Pajisjet e makinerisë mirëmbahen me sistem vajosje.
2. Bën pastrimin e naftës
3. Filtrimin e naftës
4. Riciklimin e vajit
5. Menaxhimin e mbeturinave të vajit
6. Kursen energji

Skema më poshtë ilustron mënyrën e trajtimit të mbetjeve të vajit.





Përfitimet që mund të vijnë nga përdorimi i teknologjive moderne:


1. Kjo teknologji ndikon në përfitim të lëndëve sekondare në industrinë e kaldajave. Këtë përfitim e kemi pas trajtimit të vajrave të përdorur, të cilët mund t'i shfrytëzojmë për lubrifikantë.
2. Ruan mbeturinat e krijuara nga shfrytëzimi i materialeve
3. Redukton koston

Pavarësisht një lloj cudie që mund të shkaktojë për faktin se konsiderohet si mbeturinë, vaji i përdorur po shihet kudo si mundësi për të krijuar benefite në funksione të ndryshme teknologjike.

Përdorimi i teknologjive që përpunojnë këtë lloj vaji, mund të rezultojë zgjidhje eficiente për disa degë të industrisë. Vajrat e përftuar nga gomat, plastikat, apo edhe lëndë të tjera, janë një mundësi më tepër për të pasuruar dhe bërë më të thjeshtë përpunimin teknik, pa shkaktuar asnjë kosto. Sa më shpejt të kuptohet rëndësia e përdorimit të teknologjive që punojnë me vajra të përdorur, aq më shumë përfitime do të ketë vetë industria, teknologjia dhe shumë pajisje të tjera që shërbejnë në sektorë të ndryshëm.

***Përgatiti Raportin;***  
***Green-Studio***  
**Ing Ervis MALAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 4935 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 361

## **ÇERTIFIKATË**


Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

**Z. ERVIS MALAJ**

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.


**MINISTRI**

  
**Lefter KOKA**



**GREEN-STUDIO**

Adresa: Lagja 7 Rr. Hajdar Demiri Durres  
Cel +355 69 37 67 595  
E-mail: green-studio@hotmail.com



Green-Studio





MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

## LICENCË



LN-9472-04-2015	NUIS/NIPT: L51607502C
Subjekti: Ervis Malaj	
Adresa: Durres, DURRES, Durres, DURRES, Lagjia 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kati i parë.	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 12/02/2016	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
<b>Kategoria</b> Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
<b>Nënkategoria</b> Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
<b>Veprimtari specifike</b> 1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Adresa: Durres, DURRES, Durres, DURRES, Lagjia 7, rruga Hajdar Demiri, pallat 8-katësh, zona kadastrale 8512, nr pasurisë 5/192, kati i parë.	
<b>Specialiteti</b> Pa afat veprimtari	
<b>Kategoria</b> Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportelit:

SHUKIT TRASK



Veprimtari të e abshirësve ndikim në mjedis, pa afat veprimtari